



Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

Kodi: 009

KEC

HAP PAS HAPI

Trajnimi avansues për edukatorë që punojnë me fëmijë të moshave 3-6 vjeç

Qëllimet e Programit

Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit përfitojnë:

- Njohjen e *koncepteve* të përgjithshme *filozofike* dhe bazën teorike të *programit me në qendër fëmijën*
- Njohjen e *praktikave të përshtatshme zhvillimore* që mbajnë parasysh fëmijën në tërësi si genie intelektuale, sociale dhe emocionale
- Aftësi për organizimin e *mësimit të individualizuar*, që nënkupton respektimin e potencialit zhvillimor të secilit individ në aspektin psiko-social, fizik, shoqëror, gjinor
- Aftësi për krijimin e mundësive për liri të shprehjes, të drejtën për zgjedhje dhe vendosjen për përgjegjësi që reflektojnë *frymën demokratike në klasë*
- Aftësi për *organizimin e mësimit kooperativ* që nxit bashkëveprim të hapur dhe të përgjegjshëm
- Aftësi për *planifikimin e mësimit tematik* me qëllim të ngritjes së cilësisë së mësimdhënies
- Shkathtësi për *vëzhgimin e fëmijës dhe vlerësimin e efekteve të punës në klasë*

- Aftësi për aplikimin e teknikave të përshtatshme të mësimdhënies në procesin e përvetësimit të njohurive nga përmbajtjet e ndryshme programore
- Ide për krijimin e një *ambienti stimulus për mësimnxënie aktive*
- Njohuri për *përfshirjen e familjes* në realizimin e programit

Përmbajtja e trajnimit avansues për klasën e parë

Individualizimi, planifikimi global, planifikimi mujor-javor, planifikimi ditor, dita e balancuar, vëzhgimi, dokumentimi, vlerësimi, përfshirja e familjes, prezemntimi i librit (matematika, blloqet, shkenca, lexin-shkrimi prezentimi i librit, arti figuratov, familja-dramatizimi, rëra dhe uji).

Grupi i synuar

Ky program u dedikohet edukatorëve të cilët punojnë me fëmijë të moshave 3-6, të punësuarve në administratë arsimore, zyrtarëve të arsimit, pedagogëve, profesorëve dhe studentëve të Universitetit, si dhe trajnerëve të programit.

Forma e organizimit/Kohëzgjatja

Trajnimi avansues për edukatorë realizohet me anë të një trajnimi 5 ditorë që përfshin gjithsej 40 orë. Ky trajnim pasohet me 4 punëtori një ditore gjatë një viti akademik.

Me qëllim që të përcillet puna në kontinuitet dhe të punohet sa më shumë në cilesi të punës çdo muaj parashifen monitorime në klasë.

Certifikimi

Kusht për certifikim është pjesëmarrja 90% në trajnime.